

Shtetasit shqiptarë me banim jashtë vendit, që janë mbajtës të një karte identiteti dhe karte shëndeti shqiptare, për periudhën e qëndrimit në Shqipëri, shërbimi i dializës do të ofrohet falas.

Të sëmurët ose familjarët e tyre, për trajtimin me hemodializë duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore, të FSDKSH (tek Qendra Spitalore Universitare Tiranë, adresa: Rruga e Dibrës 372, Tiranë, 1000) duke paraqitur:

- Dialysis Sheet - dokument që vërteton sëmundjen dhe trajtimin me dializë të tij, lëshuar nga qendra e dializës e vendit ku banon (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar),
- Analizat e fundit mujore (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar),
- kërkesën për trajtim të të sëmurit (të shkruar me dorë, periudhën që do qëndrojë, qytetin/ qendrën ku do të marrë shërbimin, nënshkrimin, datën e kërkesës),
- kartë identiteti,
- kartë shëndeti (të vlefshme).